



## DINAMIKA DHE MËNYRA E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT

### Aplikimi

Aplikimi fillon me shpalljen zyrtare të konkursit për “fazën e tretë të vendosjes së bizneseve në Parkun e Biznesit në Drenas”.

Aplikimi është i vlefshëm kur biznesi ofron:

1. Fletë aplikacioni i mbushur
2. Certifikata e regjistrimit të biznesit,
3. Biografi e kompanisë,
4. Referenca për kompaninë
5. Dëshmi mbi përmbushjen e obligimeve tatimore,
6. Dëshmi mbi numrin aktual të punësuarve,
7. Planin e Biznesit,
8. Projektin e ndërtimit (projektin ideor), dhe
9. Licenca për ushtrim të veprimtarisë (kjo vlen vetëm për bizneset që ofrojnë shërbime të përbashkëta).

Vërejtje: Shfrytëzo hartën interaktive të Parkut të Biznesit në Drenas për të evidencuar në aplikacionin tuaj numrin e ngastrës për të cilën ju jeni të interesuar, <http://clients.rrota.com/sme/#>

**Sqarim: Parcelat me ngjyrë të kuqe, janë të zëna, kurse parcelat me ngjyrë të gjelbër janë të lira.**

**Bizneset që ofrojnë shërbime të përbashkëta si:** karburante+gaz, shërbime të telefonisë dhe internetit, shërbime hoteliere, shërbime të teknologjisë informative-Qendër Informative, si dhe kanë programe të ngjajshme, kanë të drejtë aplikimi vetëm në parcelat Nr. I-01, B, B-6, B-7, B-8 dhe B-10 (dy pjesë).

### Vlerësimi:

Konkursi i Fazës së tretë është një konkurs permanent pa afat të mbylljes dhe kompanitë që konkurrojnë për të marrë ngastrat të lira më nuk kanë nevojë të presin afatet kohore të cilat kanë vlejtur për dy periudhat e më parme po menjëherë fillohet me negociime.